

## SKEDA E GJYKIMIT NE TRE SHKALLE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga :

**Xhezair Zaganjori** - Kryesues  
**Arjana Fullani** - Anëtar  
**Evelina Qirjako** - Anëtar  
**Medi Bici** - Anëtar  
**Tom Ndreca** - Anëtar

me sekretare gjyqësore **Dorina Dulaj**, në Tiranë, sot më datë **03.05.2017**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative që i përket:

**PADITËS:**

**Rajmond Xurre (në mungesë);**

**E PADITUR:**

**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në mungesë);**

**OBJEKTI:**

1. Anulimin e aktit administrativ, vendimit Nr. 1238, datë 31.07.2014, të Komisionit të Disiplinës i DPT-ve, për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, dhe urdhërimin e të paditurit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që të kthejë paditësin në detyrë;

2. Detyrimin e të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të paguar rregullisht pagën deri në kthimin në detyrë e në vijim sipas ligjit;

**BAZA LIGJORE:**

Kushtetuta e RSH, neni 15/1, neni 44, neni 154 e vijues i K.P.C. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Udhëzimi nr. 1, datë 01.02.2014 i D.A.P, VKM 115, datë 05.03.2014, Manuali “Për organizimin dhe funksionimin e sektorit të verifikimit në terren”.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 42, datë 16.01.2015, ka vendosur: *1. Pranimin e padisë së paditësit Rajmond Xurre. 2. Shfuqizimi ne vendimit nr. 1238 prot., datë 31.07.2014 të Komisioni të Disiplinës i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”. 3. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të kthejë paditësin në detyrë dhe t'i paguajë atij pagën. 4. Ekzekutimin e këtij vendimi duhet e behet nga subjekti i paditur jo me vone se një muaj nga marrja e vendimit formë të prerë dhe paraqitja e kërkesës për ekzekutim nga kreditori duke hequr efektet e vendimit për dhënien e masës disiplinore objekt gjykimi pra fshirjen e masës disiplinore si dhe pagimin e pagës që nga koha e ndërprerjes së saj, ndërsa ekzekutimi i detyrueshëm bëhet nga përmbaruesi gjyqësor.*

**Gjykata e Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 1218, datë 28.05.2015, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 16.01.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

### V E N D O S I:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 1218, datë 28.05.2015, të Gjykatës së Apelit Administrativ.

Tiranë, më 03.05.2017

Nr. 31003-01903-00-2015 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2017-574 i Vendimit (335)